



Instituti i Kosovës për Drejtësi  
Kosovo Law Institute  
Kosovski Institut Pravde

# FALJA NË KOSOVË 2

Realizimi i këtij projekti u mundësua me mbështetjen e UNDP Kosovë, ndërsa qëndrimet e prezantuara në këtë studim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të donatorit.



*Empowered lives.  
Resilient nations.*

Autorë: Adem Gashi dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

## RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

9-A, 5

Rr. Rexhep Luci

Prishtinë

T: +381 38 73 34 90

E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)

[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

Dhjetor 2013

Prishtinë, Republika e Kosovës

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Falja paraqet një pushtet të jashtëzakonshëm të Presidentit për t'i falur personat e dënuar për krime, duke i liruar plotësisht apo pjesërisht nga ekzekutimi i dënimit përfundimtar i gjykatës. Hyrja në fuqi e Ligjit për Faljen, i ka siguruar Presidentit që për herë të parë në vitin 2009 të shfrytëzoj të drejtën diskrecionale për të falur personat e dënuar nga gjykatat. Deri më tani, Presidentët i kanë falur pjesërisht dhe në tërësi rreth 250 vjet burgim për 246 persona të dënuar, ku vetëm 11 kanë qenë gra. Zbatimi i institutit të faljes kishte shqetësuar tej mase personat e dënuar të cilët kishin ngritur dilema rreth vlerësimeve objektive. Po ashtu, grupe tjera kishin ngritur shqetësimet e tyre rreth zbatimit të këtij instituti, përfshirë këtu Komisionin Evropian.

Në mesin e personave që kanë përfituar falje janë përfshirë personat e dënuar për vepra penale serioze duke përfshirë vrasje mizore, vrasje të rënda, krim të organizuar, vepra që ndërlidhen me narkotik, dhunim, si dhe përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës. Falja e personave të dënuar për këto vepra penale ka ngritur dilema në qoftë se kriteret mundësojnë vlerësim objektiv dhe në qoftë se kriteret e vendosura me ligj janë respektuar plotësisht nga Komisionet Ad Hoc dhe Presidentët. Madje në një rast, Presidenti kishte falur një të dënuar në kundërshtim me Ligjin për Falje. Rrjedhimisht, shumë kritika janë ngritur sa i përket zbatimit të faljes në Kosovë.

Zbatimi i faljes në mënyrë arbitrare ka ndikuar edhe në degradimin e këtij instituti, qysh në fillet e zbatimit të tij. Situata e krijuar patjetër se kërkon një përgjigje dhe atë të menjëhershme për të harmonizuar dhe përmirësuar aktet normative që rregullojnë këtë fushë. Një nga sfidat e mëdha në këtë nismë do të jetë mungesa e standardeve universale që do të orientonin angazhimin e krijimit të modelit të përshtatshëm për Kosovën. Rrjedhimisht, bazë e punës në këtë nismë duhet të jetë konteksti i Kosovës dhe praktikat më të mira nga vendet e ndryshme.

Rëndësi e madhe duhet kushtuar punës së Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK). Deri më tani, SHKK ka marrë kritika të mëdha për raportet e saja sa i përket besueshmërisë, profesionalizmit, dhe objektivitetit. Pa raporte të tilla për të dënuarit, do të jetë e vështirë të ketë zbatim të drejtë dhe meritore të faljes. Raportet e SHKK-së kanë peshë të madhe në informimin e Presidentit për të marrë vendime.

Sa i përket dispozitave ligjore që ndërlidhen me institutin e faljes, janë identifikuar disa çështje të cilat kërkojnë debat më të gjerë. Këto çështje janë të listuara më poshtë, janë analizuar në kontekstin e Kosovës, dhe janë bërë krahasime edhe me vende tjera.

## II. METODOLOGJIA

Autorët e këtij raporti janë autorët e raportit të vetëm që kanë analizuar zbatimin e institutit të faljes në Kosovë. Në përpilimin e këtij raporti, IKD ka përdorur tri mjete për të ardhur deri tek këto përfundime: hulumtimin primar, sekondar dhe diskutimin e strukturuar me akterët relevant. IKD ka hartuar pyetjet e hulumtimit dhe ka zhvilluar intervista me tetë zyrtarë të ndryshëm. Këto

intervista janë kodifikuar dhe janë pasqyruar në frymën e analizës. Në ndërkohë, IKD ka zhvilluar hulumtim në zyrë ku janë analizuar Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji për faljen, Dekreti i Presidentit rreth Kriteve, Komentari i Kushtetutës, raporte të ndryshme vendore e ndërkombëtare që kanë trajtuar çështjen e faljes në Kosovë, është zhvilluar analizë krahasuese rreth legjislacionit në Shqipëri, Kroaci, Amerikë, Gjermani, Austri, Francë, Maqedoni, dhe të tjera. Pas përpilimit të draft analizës, IKD ka zhvilluar takim të strukturuar të përbashkët me aktorët kyç sa i përket faljes. Diskutimi i strukturuar ka shërbyer për të debatuar rreth kufizimeve, kriteve dhe procedurave sa i përket procesit të faljes. Përfundimisht, janë nxjerrë rekomandimet të cilat janë inkorporuar në dokumentin përfundimtar.

### III. TRENDET E ZBATIMIT

Falja paraqet pushtetin e jashtëzakonshëm të Presidentit për t'i falur personat e dënuar për krime, duke i liruar plotësisht apo pjesërisht nga ekzekutimi i dënimit përfundimtar të gjykatës. Falja nuk është e drejtë e të dënuarit, por e drejtë e Presidentit për t'iu falur atyre dënimet.<sup>1</sup> Në Kosovë ky institut ka filluar të zbatohet pas aprovimit të Ligjit për Faljen në vitin 2009, duke ia garantuar Presidentit këtë të drejtë diskrecionale për të falur të dënuar. Megjithatë, korniza e tanishme ligjore për faljen e të dënuarve paraqet kolizion ligjor, është e mangët, ndërsa kriteret dhe procedurat e faljes janë të përgjithshme dhe pamundësojnë zbatim të drejtë dhe me meritë të institutit të faljes.<sup>2</sup> Ligji me kriteret të përgjithësuara krijon hapësirë të keq-interpretimit dhe arbitraritetit.<sup>3</sup>

Falja e zbatuar në Kosovë në pesë vitet e fundit, pothuajse sikurse në të gjitha vendet e tjera, ka ngritur polemika rreth rasteve të falura. Deri më tani, Presidentët i kanë falur pjesërisht dhe në tërësi rreth **250 vjet burgim për 246 të dënuar** (11 nga to gra). Presidentët kanë falur të dënuar në kundërshtim me kriteret (recidivist dhe me shkelje disiplinore) dhe Ligjin për Falje (të dënuar për Trafikim me Qenie Njerëzore). Në kategorinë e të falurve janë përfshirë të dënuar për vrasje mizore, vrasje të rënda, krim të organizuar, vepra të ndërlidhura me narkotik, dhunim, si dhe përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës.<sup>4</sup>




Figura 1 - Trendi i faljeve ndër vite (2009 dhe 2010 – Presidenti Fatmir Sejdiu, 2011 – ud Presidenti Jakup Krasniqi, 2012 dhe 2013 – Presidentja Atifete Jahjaga)

Faljet e tilla kanë paraqitur zhvlerësim të krimit në Kosovës. Rrjedhimisht, Presidentët kanë falur personat e dënuar për vepra penale të cilat janë kategorizuar si krime të rrezikshme për shoqërinë nga institucionet shtetërore. Pikërisht në kohën kur personat në fjalë janë falur, për luftimin e këtyre veprave ka pasur strategji nacionale sikurse Strategjitë dhe Planet e Veprimit Shtetëror kundër Krimit të Organizuar 2009-2012, Korrupsionit 2009-2011, Kundër Drogave 2009-2012,

<sup>1</sup> Salihu I., E drejta Penale, Amnistia dhe Falja, Kapitulli VII, Pjesa e Përgjithshme (Prishtinë: tetor 2008), f. 569.

<sup>2</sup> Musliu B., Gashi A., *Falja në Kosovë: Analizë e zbatimit të Institutit të Faljes dhe Lirimit me Kusht* (Prishtinë: Instituti i Kosovës për Drejtësi, janar 2012), f. 4.

<sup>3</sup> IKD intervistë me z. Selim Selimi, Këshilltar Juridik i Presidentes Jahjaga, dhjetor 2013.

<sup>4</sup> Shih Ankesa A – Rastet e falura për vitin 2010 dhe 2011.

si dhe Strategjinë e Sigurisë për Kosovën. Duke vlerësuar se këto krime vazhdojnë të mbesin problematike për shoqërinë kosovare, institucionet shtetërore kanë hartuar sërish strategji sikurse Strategjia Nacionale Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Plani i Veprimit 2011-2014, Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës kundër Narkotikëve dhe Plani i Veprimit 2012-2017, Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës kundër Krimit të Organizuar dhe Plani i Veprimit 2012-2017, Strategjia për Kontrollimin dhe Mbledhjen e Armëve të Vogla dhe të Lehta dhe Plani i Veprimit i Republikës së Kosovës 2013-2016.

Gjatë këtyre viteve rreth **70 %** e të dënuarve të falur, paraprakisht iu ishte **refuzuar lirimi me kusht** nga Paneli për Lirim me Kusht. Përgatitja e raporteve nga ekipet multi-profesionale të Shërbimit Korrektues të Kosovës vazhdimisht ka qenë problematike si për Komisionet Ad hoc për Falje të Presidentëve si për Panelin për Lirim me Kusht. Këto raporte kanë qenë kundërthënëse, të pasakta, shabllon dhe jokonkrete, raporte këto të cilat janë vendimtare për vlerësim pozitiv në kuptim të respektimit të kriterëve ligjore për falje.

Përbërja e Komisioneve Ad hoc ka qenë problematike për shkak se shumica e anëtarëve kanë qenë aktiv në parti politike. Mungesa e procesverbaleve si dhe rregullave për vendimmarrje vetëm sa kanë kontribuar më shumë në këtë drejtim. Në vitin 2010, Komisioni Ad hoc kishte sugjeruar dhe Presidenti kishte falur një të dënuar në kundërshtim me Ligjin për Faljen. Në këtë periudhë, me sugjerim të Komisionit Ad hoc, Presidenti kishte falur personin e dënuar për Trafikim me Qenie Njerëzore, në kundërshtim me Ligjin për Falje. Prokurori i Shtetit ka iniciuar hetime preliminare për këto falje.

#### *Historik i shkurtër i praktikave të këqija të zbatimit të instituteve të faljes dhe lirimimit me kusht*

Zbatimi i instituteve sikurse Lirimi me Kusht dhe Falja ka rezultuar të jetë tejet problematik në Kosovë. Deri në zbatimin e institutit të faljes në vitin 2009, në Kosovë kishte funksionuar vetëm një mekanizëm për lirinë me kusht për të dënuarit, përkatësisht Paneli për Lirim me Kusht. Ky panel për çdo vit ishte ngarkuar tej mase me kërkesa të vazhdueshme të të dënuarve për lirim me kusht. Me rritjen e rëndësisë së këtij paneli ishin shtuar edhe mundësitë e keqpërdorimeve me lirim e të burgosurve ku ishin përfshirë edhe anëtarët e Panelit për Lirim me Kusht.<sup>5</sup> Madje, zyrtari më i lartë i Panelit për Lirim me Kusht ishte arrestuar dhe më vonë dënuar për keqpërdorimet e bëra me lirim e të dënuarve.<sup>6</sup> Edhe pas kësaj, keqpërdorimet me lirinë e të burgosurve në Panelin për Lirim me Kusht kishin vazhduar. Në janar të viti 2011, Policia e Kosovës kishte arrestuar njërin prej gjykatësve porotë të Panelit nën dyshimin se kishte marrë mito për të liruar të burgosurit. Problemet e vazhdueshme, aso kohe, kishin detyruar ministrin e Drejtësisë, z. Hajredin Kuçi, të suspendonte në tërësi Panelin për Lirim me Kusht, për ta

<sup>5</sup> Çështja e Panelit për Lirim me Kusht ishte temë e ngritur nga gazeta ditore Lajm, dhe po kjo gazetë ka përcjellë në vazhdimësi aktivitetet e këtij Paneli duke përfshirë shkrime hulumtuese të botuara në vitet 2005, 2006, 2007 dhe 2008.

<sup>6</sup> Aktgjykimi që ndërlidhet me veprimtaritë korruptive të të dënuarit Sokol Quse (qasur për here të fundit [http://ëëë.eulex-kosovo.eu/docs/justice/judgments/criminal-proceedings/SupremeC/01-11-SokolQuse/%282011.04.05%29%20JUD%20-%20Sokol%20QUSE%20%28SC%29.ALB\\_redacted.pdf](http://ëëë.eulex-kosovo.eu/docs/justice/judgments/criminal-proceedings/SupremeC/01-11-SokolQuse/%282011.04.05%29%20JUD%20-%20Sokol%20QUSE%20%28SC%29.ALB_redacted.pdf))

ristrukturuar dhe rifilluar me seanca tek me 19 prill 2011. Për shkak të dyshimeve për keqpërdorime ministri Kuçi kishte vendosur të rishikonte të gjitha vendimet e Panelit për Lirim me Kusht të marra prej datës 16 tetor 2010 deri më 24 shkurt 2011. Ishin rishikuar 263 vendime të Panelit, ndërsa Komisioni ad hoc i formuar nuk kishte hasur në ndonjë veprimtari korruptive. Problemet sërish janë riaktualizuar në vitin 2013, kur Prokuroria ka ngritur aktakuzë ndaj gjykatësve dhe zyrtarëve të Panelit për Lirim me Kusht. Për shkak të ngritjes së aktakuzës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka suspenduar nga puna tre gjykatës dhe një punonjës të Panelit për Lirim me Kusht, nën akuzën se kishin liruar të dënuarit në mënyrë të kundërligjshme.<sup>7</sup> Problemet ligjore dhe ndjekja nga organet hetuese e kanë përcjell edhe zbatimin e institutit të faljes. Raportet e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2010 dhe 2011, kanë kritikuar faljet e bëra nga ish-Presidenti Fatmir Sejdiu dhe ish Ushtruesi i Detyrës Jakup Krasniqi. Pas kësaj në janar 2012 për herë të parë Instituti i Kosovës për Drejtësi publikoi hulumtimin dhe analizën e thellë për zbatimin e faljes dhe lirimin me kusht në Kosovë. Ky raport futi nën hetime preliminare dy ish-Presidentët<sup>8</sup>, dhe zyrtarët e tjerë të cilët kishin shërbyer në proceset e faljeve të bëra gjatë viteve 2009, 2010 dhe 2011, të cilat ishin zbatuar në masë të madhe në kundërshtim me kriteret dhe Ligjin për Falje.

### *Saktësia e informatave për vlerësim*

Raportet e ekipeve të Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK) janë shumë të rëndësishme për vendimet përfundimtare të faljes nga Presidenti. Këto raporte përshijnë vlerësimet e punëtorit social, zyrtarit ligjor, psikologut, mjekut, përgjegjësit për siguri, zyrtarit për aftësim profesional, zyrtarit për punësim, zyrtarit për arsimim, udhëheqësit për programe dhe regjime të të burgosurve, si dhe psikiatrit. Të njëjtat raporte përgatiten si për Komisionin Ad hoc për Falje të Presidentit ashtu edhe për Panelin për Lirim me Kusht (PLK). Përpilimi i këtyre raporteve vazhdimisht ka qenë problematik, për shkak të mangësive, joprofesionalizmit dhe dyshimeve për keqpërdorim gjatë vlerësimit.<sup>9</sup> Ndodh që dokumentacioni i ofruar nga SHKK të mos jetë i kompletuar, madje ka raste kur iu mungon edhe vula. SHKK duket të mos ketë ekspertizë të mjaftueshme për vlerësim gjithëpërfshirës dhe adekuat.<sup>10</sup> Tanimë, PLK ka përbërje të re, e cila vazhdon të ballafaqohet me problemet e vjetra. Gjatë shqyrtimit të 20 kërkesave të para gjatë dy seancave, problemet më serioze ndërlidhen me përlllogaritjen e gabuar të dënimit për të dënuarit, vlerësime të gabuara, shabllone dhe jokonkrete, si dhe probleme tjera. Joprofesionalizmi i këtyre

<sup>7</sup> “Këshilli Gjyqësor i Kosovës suspendoi tre gjyqtarë”. Koha.net. Publikuar me 10 shtator 2013. (qasur për here të fundit me 15 dhjetor 2013 <http://ëëë.koha.net/?page=1,13,158293>)

<sup>8</sup> Hetohen Sejdiu dhe Krasniqi. Telegrafi.com. Publikuar me 12 mrs 2012.( qasur për herë të fundit me 15 dhjetor 2013 <http://ëëë.telegrafi.com/lajme/hetohen-sejdiu-e-krasniqi-2-20887.html>)

<sup>9</sup> IKD intervistë me znj. Tonka Berishaj, ish-Kryetare e Panelit për Lirim me Kusht si dhe znj. Emine Kaqiku, Kryetare e Panelit për Lirim me Kusht, dhjetor 2013.

<sup>10</sup> IKD intervistë me znj. Fatmire Haliti, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve dhe Torturës, dhjetor 2013.

raporteve shpjegohet edhe nga Kryetarja e tanishme e PLK-së, e cila thotë se “[ekipet e SHKK-së] kanë vlerësuar sjellje shembullore dikë që ka pasur shtatë shkelje disiplinore.”<sup>11</sup>

Drejtuesit e Panelit për Lirim me Kusht vlerësojnë se nuk mund të jenë të gjithë të dënuarit njëjtë të vlerësuar, sepse secili dallon për nga vetitë dhe sjelljet. Bazuar në raportet dhe vlerësimet që vijnë nga ekipet e SHKK-së në Panelin për Lirim me Kusht, rezulton se 95% e rasteve të të dënuarve duhet të lirohen me kusht<sup>12</sup>. Raportet që përgatiten për Komisionin Ad hoc për Falje Presidenciale nuk janë profesionale dhe nuk përmbajnë një ekstrakt për secilin të dënuar. Të dhënat mbesin të mangëta, ndërsa dosjet ofrohen nëpër paketa të thjeshta që rrezikojnë dëmtimin apo humbjen e dokumentacionit.<sup>13</sup> Në anën tjetër, drejtuesit e SHKK-së vlerësojnë se ka nevojë për ngritje profesionale të ekipeve që përpilojnë këto raporte, por theksojnë se asnjëherë nuk kanë pasur vërejtje me shkrim nga institucionet e tjera rreth këtyre raporteve.<sup>14</sup>

## IV. ANALIZË LIGJORE

*Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, përkatësisht *Kapitulli V, Kompetencat e Presidentit, neni 84.29*, përcakton të drejtën e Presidentit për të shpallur falje individuale, sipas ligjit. *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, sikurse shumë Kushtetuta të vendeve të ndryshme, i ka garantuar Presidentit të drejtën për shpallje të faljes pa vendosur kufizime. Rrjedhimisht, është mjaftë e diskutueshme se deri në çfarë mase mund të vendosen kufizime ligjore për zbatimin e këtij instituti.

*Komentari i parë ligjor i Kushtetutës së Republikës së Kosovës*, e cilëson pa të drejtë *faljen* si kompetencë tipike ceremoniale të Presidentit.<sup>15</sup> *Falja* paraqet pushtet të jashtëzakonshëm ekzekutiv dhe të drejtë diskrecionale të Presidentit.<sup>16</sup> Rrjedhimisht, *falja* nuk hynë në kategorinë e kompetencave ceremoniale, pasi që “[ato] janë kompetenca formale pa ndikim.”<sup>17</sup>

Hartimi dhe miratimi i akteve ligjore rreth institutit të faljes kanë jetësuar të drejtën e faljes sipas kërkesave të Kushtetutës. Zbatimi i faljes është rregulluar me *Ligjin për Faljen, Kodin Penal, dhe Dekretin e Presidentit*.<sup>18</sup> *Ligji për Faljen*, që ka përcaktuar procedurat dhe kriteret për faljen, është miratuar në vitin 2008 dhe është zbatuar për herë të parë në fillim të vitit 2009. *Kodi Penal* ka ndryshuar në vitin 2013, duke ndryshuar edhe çështje substanciale rreth faljes. Në vitin 2012,

<sup>11</sup> Intervistë me znj. Emine Kaqiku, Kryetare e Panelit për Lirim me Kusht. Dhjetor 2013.

<sup>12</sup> Intervistë me znj. Tonka Berishaj, ish-Kryetare e Panelit për Lirim me Kusht. Dhjetor 2013.

<sup>13</sup> Intervistë me z. Selim Selimi, Këshilltar Juridik i Presidentes Atiefete Jahjaga. Dhjetor 2013.

<sup>14</sup> Intervistë me z. Shemsi Hajrizi, Ushtrues Detyre i Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së. Dhjetor 2013.

<sup>15</sup> Hasani E., *Komentar: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Botimi I* (Prishtinë: GIZ, dhjetor 2013), f. 412. *Shënim*: Kjo pjesë nuk është edhe shumë relevante për punimin, megjithatë, duke pasur parasysh se ky është komentari i parë dhe i vetëm i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

<sup>16</sup> Neni 2, Përkufizimet, Ligji për Faljen, Ligji numër 03/L-101.

<sup>17</sup> IKD intervistë me z. Driton Muharremi, Ligjërues i të drejtës së procedurës penale, Universiteti AAB.

<sup>18</sup> Kodi i Përkohshëm Penal i zbatuar nga viti 2004 deri në dhjetor 2012, ndërsa Kodi i ri Penal ka filluar së zbatuari nga 1 janar 2013.



Presidentja ka nxjerrë një *Dekret* të ri duke saktësuar më tutje kriteret dhe procedurat për zbatimin e faljes.<sup>19</sup>

Sikurse që u cek më lartë, *Kushtetuta* nuk ka kufizuar *faljen*. Megjithatë, *Ligji për Faljen* ka vendosur kufizime, ku nga falja përjashton personat në ndjekje penale, që iu shmangen ekzekutimit të dënimit, të cilëve iu është refuzuar falja për të njëjtën vepër penale, dhe të dënuarit nga Kapitulli XIII (v.p. kundër Kosovës apo banorëve të saj) dhe XIV (v.p. kundër të Drejtës Ndërkombëtare) i Kodit të vjetër Penal. Ndërsa *Kodi i ri Penal*, nga *falja* përjashton personat në ndjekje penale dhe të dënuarit e refuzuar nga Paneli për Lirim me Kusht. Ndërsa, *Dekreti i Presidentit* nuk ka vendosur kufizime por ka shtuar kriteret në pajtim me ligjin. Të gjitha këto kufizime si dhe procedurat e mangëta janë temë e diskutimeve në qoftë se mundësojnë zbatim transparent dhe jetësojnë garancitë e shprehura në Kushtetutë.

Është jo racionale që procedurat, kriteret dhe kufizimet për falje janë shpërndarë në dy akte ligjore dhe një dekret. Kjo ka rezultuar edhe me kolizion ligjor ku Kodi Penal ofron mundësinë e zëvendësimit të dënimit, gjë të cilën nuk e parasheh Ligji për Faljen. Po ashtu, kriteret bazë për falje të përfshira në *Dekretin e Presidentit* kanë peshë të njëjtë me kriteret bazë të vendosura në *Ligjin për Faljen*.

## V. TË DHËNA KRAHASUESE

Përmes Kushtetutave dhe ligjeve, vendet e ndryshme përcaktojnë se kush e mban të drejtën e faljes, ku kryesisht kjo e drejtë i takon ekskluzivisht Presidentit të vendit. Instituti i faljes gjithnjë është në qendër të kritikave kudo që zbatohet për shkak të hapësirës së madhe për vendim subjektiv. Varësisht prej kontekstit, shtetet ndërtojnë legjislacionin penal, përmes të cilit vendosin procedurat, kriteret dhe kufizimet në rastet e zbatimit të faljes. Nuk ekziston ndonjë standard universal që aplikohet për faljen. Në vazhdim do të japim një pasqyrë krahasuese sa i përket rregullimit të faljes në Kosovë dhe në vendet e tjera. Në mënyrë që të jetë më e lehtë të identifikohen dallimet dhe ngjasitë, kjo pjesë është ndarë në çështjet në vijim:

### a. Rregullimet e Kushtetutës

Numër i madh i Kushtetutave nëpër botë nuk përcaktojnë në detaje procedurat, fuqinë, apo kufijtë, por vetëm garantojnë një të drejtë të tillë për Presidentin. Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës përcaktohet se Presidenti bën faljen në pajtim me ligjin.<sup>20</sup> Rrjedhimisht, sikurse në pjesën më të madhe të Kushtetutave, edhe ajo e Kosovës ka lënë hapësirë që i gjithë rregullimi rreth faljes të përcaktohet në ligj të veçantë.

<sup>19</sup> Dekret për kriteret dhe procedurat për faljen e personave të dënuar, 13 janar 2012, Presidenti i Republikës së Kosovës.

<sup>20</sup> Kapitulli 5 – Presidenti i Republikës së Kosovës, Neni 83 – Kompetencat e Presidentit, Alinea 29, Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

*b. Kufizimet për Presidentin dhe ushtruesin e detyrës së tij*

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka paraparë zëvendësimin e Presidentit në raste të caktuara, ku këtë funksion e ushtron përkohësisht Kryetari i Kuvendit. Kryetari i Kuvendit do të jetë ushtrues i detyrës së Presidentit, por jo më shumë se gjashtë muaj. Gjatë kësaj periudhe, nuk përcaktohet asnjë kufizim i kompetencave për u.d. të Presidentit, që nënkupton edhe të drejtën për falje individuale. Në vitin 2011, për herë të parë u.d. i Presidentit kishte ushtruar të drejtën për falje. Dekreti i faljes kishte përfshirë 135 vjet të falura për 103 të dënuar, kryesisht për vrasje dhe vrasje të rënda.<sup>21</sup> Një gjë e tillë është evidentuar si shqetësim në raportet ndërkombëtare dhe vendore. Gjatë diskutimeve për ndryshime kushtetuese, ishte arritur konsensus që në propozimet për ndryshime të përfshihej kufizimi i kompetencave të u.d. Presidentit për të bërë falje.<sup>22</sup> Avokati i Popullit kishte ngritur shqetësim rreth një ndryshimi të tillë duke theksuar se “kompetencat si faljet individuale apo emërimi i gjyqtarëve duhet të vazhdojnë të ushtrohen nga Ushtruesi i Detyrës së Presidentit”.<sup>23</sup> Gjykata Kushtetuese ka konsideruar se “një rast i tillë ka mundësi të madhe të ndikojë në një të drejtë dhe liri themelore, pra në të drejtën e lirisë, siç përcaktohet, ndër të tjera në nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës dhe nenin 5 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut”. Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese ka konkluduar se “neni i ri i propozuar 90.5 (5) pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës”.<sup>24</sup> Praktika e kufizimit të ushtrimit të të drejtës për falje nga Presidentët nuk është diçka e panjohur dhe e largët. Për shembull, në rastin e Shqipërisë, ligji për faljen i miratuar në vitin 2010, i ka kufizuar Presidentit ushtrimin e të drejtës për të falur. Presidenti i Republikës së Shqipërisë nuk mund të dekretoj falje tre muaj para dhe pas datës së zgjedhjeve.<sup>25</sup> Në përgjithësi, shfrytëzimi i të drejtës për të falur nga Presidentët gjatë përfundimit të mandatit si dhe u.d. Presidentët gjatë periudhës së shkurtër në zyrë, është mjaftë problematike. Në vitin 2001, Presidenti Amerikan Klinton në ditën e fundit në postin e tij kishte falur 140 persona.<sup>26</sup> Megjithatë, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Presidentët prapë se prapë nuk hasin në kufizime kohore sa i përket faljeve.

*c. Informatat relevante për vlerësim*

<sup>21</sup> Musliu B., Gashi A., *Falja në Kosovë: Analizë e zbatimit të Institutit të Faljes dhe Lirimit me Kusht* (Prishtinë: Instituti i Kosovës për Drejtësi, janar 2012), f. 29.

<sup>22</sup> Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 90.5 (5) të Kushtetutës. Aktgjykim në Rastet K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12. Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës me 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012. Gjykata Kushtetuese e Kosovës. 20 korrik 2012.

<sup>23</sup> Aktgjykim në Rastet K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12. Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës me 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012. Gjykata Kushtetuese e Kosovës. 20 korrik 2012. Fq. 5.

<sup>24</sup> Po aty.

<sup>25</sup> Neni 4, Periudha për ushtrimin e faljes, Ligji për Faljen, numër 10295, 1 korrik 2010, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

<sup>26</sup> “Lista e faljeve të Klintonit” [Clinton Pardon’s List], *Ëashington Post*, 20 janar 2001, shih [http://ëëë.ëashingtonpost.com/ëp-srv/aponline/20010120/aponline135239\\_000.htm](http://ëëë.ëashingtonpost.com/ëp-srv/aponline/20010120/aponline135239_000.htm) (qasur për herë të fundit më 17 dhjetor 2013).

Ligji për faljen në Kosovën ka përcaktuar disa rrethana të cilat duhet të shqyrtohen gjatë marrjes së vendimit për falje. Këto rrethana përfshijnë peshën e krimit, rrezikun e recidivizmit, pendimin e sinqertë dhe shfaqjen e sjelljeve dhe karakterit të respektueshëm.<sup>27</sup> Përveç këtyre kriterëve, Dekreti i Presidentit ka përfshirë rrethana shtesë sikurse ndikimin e faljes te pala e dëmtuar, respektimin e rregullave për socilaizim dhe riintegrim, arsyen specifike humanitare, kohën e kaluar në vuajtje të dënimit, dhe përmbushjen e kërkesave të shërbimit korrektues.<sup>28</sup> Dekreti po ashtu ka paraqitur disa rrethana të cilat kërkojnë kujdes të shtuar gjatë shqyrtimit për disa vepra me rrezikshmëri të madhe shoqërore përfshirë këtu vrasjen e rëndë të kryer me mizori, vrasje e shumëfishtë, kundër fëmijës, gruas shtatzënë, marrëdhënies seksuale me dhunë me të mitur.<sup>29</sup> Këto nuk janë kufizime strikte por janë rrethana të cilat merren parasysh gjatë shqyrtimit.

Vlerësimi i rrethanave më lartë bëhet në bazë të informatave për të dënuarin të cilat sigurohen nga institucionet përkatëse. Të dhënat që kërkohen nga Presidenti janë të specifikuar në Dekret të Kriterëve dhe Procedurave.<sup>30</sup> Ngjashmëria e madhe e këtyre kërkesave është me ato që bëhen në Kroaci. Në Kroaci, të dhënat që Presidenti kërkon nga Ministria e Drejtësisë rreth të dënuarit janë të saktësuara në Ligj dhe jo në akte tjera normative, sikurse në rastin e Kosovës.<sup>31</sup> Për më tepër, i kërkohet Ministrit të drejtësisë që të bëjë një rekomandim mirë të arsyetuar.<sup>32</sup>

#### *d. Kufizimi, falja vetëm e të dënuarve me aktgjykim të formës së prerë*

Ligji për Falje në Kosovë ka kufizuar faljen e personave, të cilët nuk janë dënuar me një vendim përfundimtarë nga gjykata.<sup>33</sup> Ligji poashtu kufizon faljen e personave, të cilët me

<sup>27</sup> Neni 5, Kriteret për falje, Ligji për Faljen, Kuvendi i Republikës së Kosovës.

<sup>28</sup> Neni 2.2., Dekreti për kriteret dhe procedurat për faljen e personave të dënuar, 13 janar 2012, Presidenti i Republikës së Kosovës.

<sup>29</sup> Neni 2.3., ibid.

<sup>30</sup> Këto të dhëna përfshijnë: të dhënat personale për të dënuarin/en; kopja e aktgjykimit të plotëfuqishëm të gjykatës ose kopja e dispozitivit të aktgjykimit; të dhënat për punën dhe arsimimin e të dënuarit/es; të dhënat për gjendjen familjare (nurmi i fëmijëve të mitur, obligimet për mbajtje, etj); të dhënat për ekzekutimin e dënimit (vendi i mbajtjes së dënimit, afatet kohore për fillimin e mbajtjes së dënimit) përfshirë të dhënat mbi lirimimin me kusht; të dhënat për zvogëlimin ose ndërrimin e dënimit (me zbutje të jashtëzakonshme të dënimit ose falje); të dhënat nëse është paraqitur dhe realizuar kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit; të dhënat për dënimet e mëparshme (lloji i veprës penale, lloji dhe lartësia e dënimit, përfshirë vuajtjen e dënimit); të dhënat për kompensimin e dëmit të shkaktuar me veprën penale; të dhënat për vlerësimin profesional të cilësive personale të të dënuarit, përfshirë vlerësimin për prirjet për recidivizëm dhe efektin e dënimit tek i dënuari; të dhënat për sjelljen e të dënuarit gjatë vuajtjes së dënimit. Neni 3, ibid.

<sup>31</sup> Neni 10, Ligji për faljen, Kuvendi i Republikës së Kroacisë [Zakon o pomilovanju (<<Narodne Novine>> broj 175/03)].

<sup>32</sup> Ibid.

<sup>33</sup> Neni 4, E drejta për të kërkuar Falje. *Ligji për Faljen, ligji numër 03/L-101*, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 12 dhjetor 2008.

qëllim iu shmangen ekzekutimit të dënimit. Kodi Penal i Kosovës gjithashtu nuk lejon faljen e personave të cilët nuk kanë aktgjykim të formës së prerë.<sup>34</sup>

Literatura shkencore juridike-penale thekson se zbatimi i institutit të faljes shpie në shuarjen e dënimit.<sup>35</sup> Përmes faljes të dënuarve iu falet dënimi në tërësi apo pjesërisht, iu zëvendësohet dënimi me dënim më të butë, iu shlyhet dënimi nga evidenca e të ndëshkuarve, apo edhe falen duke u liruar nga ndjekja penale. Në rastet kur kjo e fundit lejohet me ligj, atëherë kemi të bëjmë me institutin e abolicionit. Ky i fundit paraqet formën më të gjerë të faljes, sepse mund të jepet në të gjitha fazat e procedurës penale, derisa nuk është nxjerrë aktgjykimi i plotfuqishëm.<sup>36</sup> Prof. Ismet Salihu thekson se falja mund të jepet për të gjitha veprat penale, duke përfshirë edhe veprat penale që ndiqen sipas padisë private. Çështja e zbatimit të institutit të abolicionit është çështje e vullnetit të vendeve, të cilat këtë të drejtë ia japin apo kufizojnë shefit të shtetit.

Në Shqipëri, Ligji për Faljen vendos se falja u takon vetëm të dënuarve me vendim të formës së prerë.<sup>37</sup> Në Kroaci, sipas ligjit për falje, falje përfitojnë vetëm personat e dënuar nga gjykatat e Republikës së Kroacisë apo vuajnë dënimin dhe pasojat tjera ligjore në Kroaci.<sup>38</sup> Po ashtu, në Itali, Austri, Zvicër, Francë, dhe vende tjera në Evropë, theksohet se falja bëhet vetëm për dënimet e shqiptuara. Ndërsa në Gjermani, një gjë e tillë nuk përmendet.<sup>39</sup>

#### *e. Kufizimi i veprave penale të cilat falen*

Në Kosovë, nuk lejohet falja për personat e dënuar në bazë të Kreut XIII (v.p. kundër Kosovës dhe banorëve të saj) apo Kreut XIV (v.p. kundër të Drejtës ndërkombëtare) të Kodit të vjetër Penal të Kosovës.<sup>40</sup> Një gjë e tillë është e paraparë me Ligjin për Faljen. Një praktikë e tillë e përjashtimit nga falja të dënuarve për vepra të caktuara gjendet edhe në Shqipëri. Ligji për Faljen në Shqipëri ndalon faljen për këto vepra Gjenocid, Krime kundër njerëzimit, Krimet e luftës, Vrasje me paramendim, Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale

<sup>34</sup> Neni 112, (1)“Me falje dhe në pajtim me Ligjin për Falje, personave të caktuar emrat e të cilëve saktësohen u jepet lirimi i plotë ose i pjesërishtëm nga ekzekutimi i dënimit, zëvendësimi i dënimit me një dënim tjetër më të butë apo dënimi me kusht ose shlyerja e dënimit”, dhe (2)“Kryesi nuk mund të falet për çfarëdo dënimi për të cilin Paneli për Lirim me Kusht i ka refuzuar lirin me kusht”. Falja, Kapitulli XI, Falja. Kodi Penal i Kosovës.

<sup>35</sup> Ismet Salihu, E drejta Penale: Pjesa e përgjithshme (Prishtinë: Universiteti Fama, 2008), Kapitulli VII: Amnistia dhe Falja, f. 569.

<sup>36</sup> “Amnistia apo falja, me të cilën kryesi i veprës penale lirohet nga ndjekja penale, quhet abolicion. Abolicioni është forma më e gjerë e amnistisë apo faljes. Me anë të abolicionit procedura nuk mund të fillohet. Nëse procedura është filluar, ajo ndalet. Abolicioni mund të jepet në të gjitha fazat e procedurës penale gjersa nuk është nxjerrë aktgjykimi i plotëfuqishëm. Efektet e abolicionit janë më të mëdha ngase kryesit të veprës penale nuk i shqiptohet dënimi, madje edhe vepra për të cilën i është dhënë abolicioni nuk mund të merret për bazë si recedivist nëse kryen vepër tjetër penale”. Ismet Salihu, E drejta Penale: Pjesa e përgjithshme (Prishtinë: Universiteti Fama, 2008), Kapitulli VII: Amnistia dhe Falja, f. 569.

<sup>37</sup> Neni 6, Kriteret ndaluese për faljen e dënimit, *alinea 1.a.*, Ligji për Faljen, numër 10295, 1 korrik 2010, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

<sup>38</sup> Ligji për faljen, Kuvendi i Republikës së Kroacisë [Zakon o pomilovanju (<<Narodne Novine>> broj 175/03)].

<sup>39</sup> Kurtovic A., *Punim shkencor mbi Faljen në Sistemin e Drejtësisë, me rastin e ligjit të ri për faljen* (Split: 2003).

<sup>40</sup> Kreu XIII dhe XIV përfshin veprat penale kundër Kosovës apo qytetarëve të saj, përkatësisht veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare. Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, *Rregullorja e UNMIK-ut 2003/25*, 6 korrik 2003.

me të mitur, Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese, Trafikimi i femrave, Trafikimi i të miturve, Vepra me qëllime terroriste, Organizata terroriste, dhe Organizata kriminale.<sup>41</sup> Në Kanada ekziston masa e cila ndalon faljen e disa veprave penale serioze edhe për një periudhë kohore të caktuar.<sup>42</sup> Në vitin 2007, Parlamenti i Kroacisë kishte diskutuar dhe propozuar që veprat penale që paraqesin rrezikshmëri të lartë për shoqërinë, sikurse veprat që ndërlidhen me narkotikët apo marrëdhënie seksuale me të mitur, të ndalohen me ligj që të mos falen.<sup>43</sup> Megjithatë, këto amendamente nuk kanë kaluar dhe nuk ekzistojnë kufizimet e tilla.

Sikurse u përmend më lartë, çdo paraqitje e kriterëve për zbatim të faljes mund të nxitë debat rreth kufizimeve që shkojnë përtej frymës së kësaj të drejte. Kufizimi për mos faljen e veprave për Kreun XIII-të, përkatësisht veprat penale kundër Kosovës apo qytetarëve të saj nga disa palë vlerësohen të tepërta dhe shprehen se falja duhet tu takoj edhe kësaj kategorie.<sup>44</sup>

#### *f. Ndërlidhja dhe ndikimi i Presidentit nga institutet dhe institucionet tjera*

Në shumë vende, Presidenti ka të drejtën diskrecionale për falje. Mirëpo, në Kosovë, me hyrjen në fuqi të Kodit Penal, në një formë falja është kufizuar paksa, duke pasur parasysh se personat e refuzuar nga Paneli për Lirim me Kusht nuk mund të falen nga Presidenti. Gjatë gjithë zbatimit të faljes në Kosovë, rreth 70% të falurve kanë qenë të refuzuar paraprakisht nga Paneli për Lirim me Kusht.

Kjo dispozitë është në kundërshtim me sistemin juridik dhe hierarkinë e pushteteve në Kosovë, sepse gjykatësit e Panelit për Lirim me Kusht rezultojnë të jenë me pushtet më të madh sesa Presidenti i Republikës”.<sup>45</sup> Askund në Kushtetutë nuk i jepet një pushtet i tillë Panelit për Lirim me Kusht. Duke pasur parasysh se falja është pushtet i jashtëzakonshëm i ekzekutiv i Presidentit për t’i falur personat nga dënimet, kjo dispozitë rezulton të jetë e pakuptimtë. Instituti i faljes dhe lirimit me kusht dallojnë për nga natyra, qëllimi dhe kriteret, prandaj nuk duhet të ketë këso kufizimesh.<sup>46</sup> Fakti që këto institute të së drejtës penale janë të ndara, nuk duhet të ndikohen nga njëra tjera dhe aq më tepër nuk duhet të ndërlidhen me kufizime përfundimtare, siç ka ndodh me Kodin e ri Penal, ku nuk mund të falen të refuzuarit nga Paneli për Lirim me Kusht.<sup>47</sup> Kjo kategori duhet të falet, por duhet të ketë kufizime ndaj saj meqenëse kriteret për falje dhe lirim me kusht janë të ngjashme, por qëllimi i zbatimit të

<sup>41</sup> Neni 6, Kriteret ndaluese për faljen e dënimit, alinea 1.a., Ligji për Faljen, numër 10295, 1 korrik 2010, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

<sup>42</sup> Kufizimi i Faljeve për Vepra të Rënda Penale [Limiting Pardons for Serious Crime Act].

<sup>43</sup> Draft-Amendamenti i vitit 2007 [Prijedlog zakona o dopuni zakona o pomilovanju s konacnim prijedlogom zakona].

<sup>44</sup> Intervistë me z. Ismet Salihu, ekspert i së Drejtës Penale. Dhjetor 2013.

<sup>45</sup> Intervista me z. Ismet Salihu, ekspert i së Drejtës Penale si dhe me z. Fejzullah Hasani, Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës. Dhjetor 2013.

<sup>46</sup> Intervistë me z. Ismet Salihu, ekspert i së Drejtës Penale, dhjetor 2013.

<sup>47</sup> Intervistë me z. Shemsi Hajrizi, Ushtrues Detyre i Drejtorit të Përgjithshëm të ShKK-së. Dhjetor 2013.

këtyre instituteve dallon.<sup>48</sup> Ka vlerësime të ndara sesi duhet të përfitojnë të dënuarit të cilët refuzohen të lirohen me kusht. Disa vlerësojnë se kjo kategori e të dënuarve duhet të falet pa asnjë kufizim ose ndaj tyre të ketë vetëm kufizime në afatet kohore, në kuptimin që të dënuarit e refuzuar në vitin e fundit për lirim me kusht nuk mund të kërkojnë falje.<sup>49</sup> Por, të tjerët vlerësojnë se për këtë kategori të drejtat e faljes duhet të jenë të kufizuara, që “në rastet kur i dënuari për lirim me kusht, nuk duhet të përfitoj falje të tërësishme, por vetëm falje të pjesshme”.<sup>50</sup>

Ndërlidhja dhe ndikimi i faljes nga institute dhe institucione tjera është evidente edhe në vendet tjera. Në vendet sikurse Austria, të drejtën e faljes, Presidenti e ndan me qeverinë.<sup>51</sup> Në Izrael, Presidenti ka kompetencë ceremoniale pasi që faljen e vendos Ministri i Drejtësisë.<sup>52</sup> Edhe në Gjermani kërkohet aprovimi nga Ekzekutivi, dhe në Francë kërkohet po ashtu aprovimi nga Ministri i Drejtësisë dhe Kryeministri. Në Suedi kjo kompetencë ka kaluar në Qeveri, ndërsa në Holandë, Monarku merr vendimin në bazë të rekomandimit të gjykatës në bazë të një akti të Parlamentit.

#### g. *Përbërja e Komisioneve Ad hoc*

Dekreti i Kriteve për Falje i Presidentit ka përcaktuar krijimin e një Komisioni Ad hoc për Falje.<sup>53</sup> Ky Komision bën shqyrtimin e të gjitha kërkesave dhe rekomandon Presidentit faljen e atyre që i plotësojnë kriteret e përcaktuara ligjore. Ky Komision prej pesë anëtarëve themelohet nga Presidenti në bazë të nevojës dhe shërben vetëm për periudhë të caktuar kohore. Para vitit 2012, mbi-popullimi i Komisionit me përfaqësues politik kishte ndikuar negativisht në procesin. Anëtarë të pavarur të këtyre Komisioneve kanë konfirmuar se në raste të caktuara ka pasur vlerësime subjektive nga anëtarët partiak.<sup>54</sup> Përjashtoj përfaqësuesin e gjyqësorit dhe dy ekspertët akademik, të gjithë anëtarët e tjerë të Komisionit Ad hoc për Falje në të kaluarën kishin qenë nga politika.<sup>55</sup> Ndërsa me dekretin për vitin 2012, është siguruar përfaqësim më profesional duke mënjeluar përfaqësimin politik.<sup>56</sup>

<sup>48</sup> Shih Aneks 2 - Ngjashmëritë dhe dallimet e kriteve për falje (Ligjit për Faljen dhe Dekreti i Presidentit) dhe Lirimit me Kusht. Intervista me z. Ismet Salihu, ekspert i së Drejtës Penale, z. Fejzullah Hasani, Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës si dhe me z. Shemi Hajrizi, Ushtrues Detyre i Drejtorit të Përgjithshëm të ShKK-së. Dhjetor 2013.

<sup>49</sup> Intervistë me z. Ismet Salihu, ekspert i së Drejtës Penale. Dhjetor 2013.

<sup>50</sup> Intervistë me z. Shemi Hajrizi, Ushtrues Detyre i Drejtorit të Përgjithshëm të ShKK-së. Dhjetor 2013.

<sup>51</sup> Kurtovic A., Punim shkencor mbi Faljen në Sistemin e Drejtësisë, me rastin e ligjit të ri për faljen (Split: 2003).

<sup>52</sup> “Punime mbi Parlamentin numër 31 [Papers on Parliament No. 31]”, *Parliament of Australia*, qershor 1998. Shih [http://ëëë.aph.gov.au/About\\_Parliament/Senate/Research\\_and\\_Education/pops/~/\\_link.aspx?\\_id=AF3D784BD9F049F7A5CF720B531FF829&\\_z=z](http://ëëë.aph.gov.au/About_Parliament/Senate/Research_and_Education/pops/~/_link.aspx?_id=AF3D784BD9F049F7A5CF720B531FF829&_z=z) (qasur së fundi më 17 dhjetor 2012).

<sup>53</sup> Neni 6, Dekreti për kriteret dhe procedurat për faljen e personave të dënuar, Dekreti numër 001-2012, Presidenti i Republikës së Kosovës, 13 janar 2012.

<sup>54</sup> Musliu B. dhe Gashi A. Falja në Kosovë. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Janar 2012.

<sup>55</sup> Intervistë me z. Ismet Salihu, ekspert i së Drejtës Penale. Dhjetor 2013.

<sup>56</sup> Shënim: Tani Komisioni përbëhet nga përfaqësues nga Zyra e Presidentit (Departamenti për Çështje Ligjore), përfaqësues nga komuniteti akademik nga lëmia e drejtësisë, përfaqësues nga shoqëria civile si dhe përfaqësues të gjyqësorit.



Në Kroaci, komisioni këshillëdhënës përbëhet nga anëtarë të cilët i zgjedh dhe shkarkon Presidenti.<sup>57</sup> Komisioni në Kroaci nuk formohet Ad-hoc por është me mandat për kohë më të gjatë.<sup>58</sup> Gjithashtu, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, brenda Departamentit të Drejtësisë ekziston Zyra e Prokurorit të Faljes, zyrë kjo që pranon aplikimet dhe bën rekomandimet për falje tek Presidenti.<sup>59</sup> Po ashtu, Maqedonia ka sistem të njëjtë, ku Komisioni Këshillëdhënës për Falje është trup me anëtarë më afatgjatë.<sup>60</sup>

#### *h. Kufizimet në rast të refuzimit të faljes*

Në Kosovë, personave të cilëve u është refuzuar falja nga Presidenti për të njëjtën vepër penale, përveç nëse dëshmohet se janë paraqitur rrethana të reja nga refuzimi i mëparshëm. Është mjaftë e paqartë se çfarë konsiderohen rrethana të reja pasi që secilin vit llogaritet se ndryshojnë rrethanat ngase ndryshon sjellja e të dënuarit gjatë vuajtjes së dënimit, prandaj kjo nuk ka logjikë.<sup>61</sup>

Neni 5 i ligjit për falje në Kroaci thekson se: aplikimi mund të përsëritet një vit nga data e vendimit përfundimtar, ndërsa për dënimet më të vogla se tre vite aplikimi mund të përsëritet çdo gjashtë muaj, ndërsa aplikimi i personit që është i dënuar me dënim të përjetshëm i lejohet të ri-aplikoj pas dhjetë viteve për herë të parë dhe më pastaj pas tre vjetëve.<sup>62</sup> Ndërsa në Shqipëri, një gjë e tillë nuk është e specifikuar.

#### *i. Zëvendësimi i dënimit*

Në Kosovën, Ligji për Faljen nuk parasheh zëvendësimin e dënimit, gjë e cila parashihet me Kodin Penal. Në Kroaci, zëvendësimi i dënimit duhet të bëhet në suaza të sanksioneve të parapara me ligj dhe në asnjë formë përfshirja e sanksioneve jashtë kornizës ligjore.<sup>63</sup> Gjithashtu, Ligji për Faljen në Shqipëri parasheh zvogëlimin e dënimit me një dënim bë të butë.

#### *j. Transparenca e Faljeve Presidenciale*

Prej vitit 2009 deri në vitin 2013 kur është zbatuar instituti i faljes në Kosovë, dy Presidentë dhe një u.d. i Presidentit, kanë shpallur pesë Dekrete të Faljes, duke përfshirë faljen e 246 personave të dënuar. Asnjëri prej Presidentëve nuk ka bërë publike në mënyrë të detajuar të

<sup>57</sup> Kurtovic A., Punim shkencor mbi Faljen në Sistemin e Drejtësisë, me rastin e ligjit të ri për faljen (Split: 2003).

<sup>58</sup> Kurtovic A., Punim shkencor mbi Faljen në Sistemin e Drejtësisë, me rastin e ligjit të ri për faljen (Split: 2003).

<sup>59</sup> Zyra e Prokurorit të Faljes, Departamenti i Drejtësisë, shih <http://ëëë.justice.gov/pardon/index.html>.

<sup>60</sup> Presidenti i Republikës së Maqedonisë, shih <http://ëëë.president.gov.mk/en/cabinet/commission-on-pardons.html>.

<sup>61</sup> Po aty.

<sup>62</sup> Neni 5, alinea 4 dhe 5, Ligji për faljen, Kuvendi i Republikës së Kroacisë [Zakon o pomilovanju (<<Narodne Novine>> broj 175/03)].

<sup>63</sup> Kurtovic A., Punim shkencor mbi Faljen në Sistemin e Drejtësisë, me rastin e ligjit të ri për faljen (Split: 2003).

dhënat për secilin të dënuar që ka përfituar nga Falja Presidenciale. Përkundër asaj se Dekreti i Kriteve për Falje i nxjerrë në vitin 2012 nga Presidentja Atifete Jahjaga, kishte shënuar progres në kuptim të specifikimit të kriteve, Dekreti<sup>64</sup> kishte dështuar të plotësonte një ndër kriteret bazë për sigurimin e plotë të transparencës.

Askund nuk specifikohet që lista me të dënuarit e të falurve e publikuar duhet të përmbajë të dhënat si emrin, mbiemrin, datën e lindjes, kohën e dënimit, veprën penale për të cilën është dënuar, gjykata që ka shqiptuar dënimin, vendi ku vuan dënimin, si dhe koha e falur për të dënuarit. Të gjitha këto të dhëna për përfituesit e Faljes Presidenciale do duhej të përfshiheshin në mënyrë që të sigurohet transparencë në lidhje me procesin e faljes. Kjo mangësi kishte bërë që Presidentët vazhdimisht të fshehin kohën e falur nga të dënuarit, pasi Dekretet për Falje të publikuara përmbanin informata selektive, duke ngritur dyshime në publik poashtu tek të dënuarit e tjerë rreth korrektësisë në ndarje të faljes. Dekreti i vitit 2012 kishte përcaktuar se përbërja e Komisioni Ad hoc për Falje do të bëhet publike së bashku me procedurat dhe vlerësimet përkatëse të Komisionit pas shpalljes së Dekretit për Falje. Një kërkesë e tillë ligjore nuk është përmbushur nga Presidenti. Sidoqoftë, dispozitat ekzistuese dështojnë të rregullojnë këtë segment të rëndësishëm për të siguruar korrektësi dhe transparencë në procesin e faljeve, duke i ofruar të dhënat specifike për të gjithë të dënuarit që përfitojnë falje.

#### *k. Të drejtat e palëve të treta*

Falja assesi nuk duhet të cenohet të drejtat e personave të tretë, të cilët janë dëmtuar me veprë penale dhe kanë të drejtë të kërkojnë kompensimin e dëmit. Madje, kjo e drejtë palëve të treta nuk iu cenohet as në rastet kur jepet abolicioni, pra as në rastet kur kemi të liruar nga ndjekja penale.<sup>65</sup> E drejta për mjet juridik është e drejtë e garantuar me Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut si dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kodi Penal e thekson qartë se me dhënien e faljes nuk preken të drejtat e personave të tretë që bazohen në dënim apo aktgjykim.<sup>66</sup>

---

<sup>64</sup> Dekreti për kriteret dhe procedurat për faljen e personave të dënuar, Dekreti numër 001-2012, Presidenti i Republikës së Kosovës, 13 janar 2012.

<sup>65</sup> Ismet Salihu, E drejta Penale: Pjesa e përgjithshme (Prishtinë: Universiteti Fama, 2008), Kapitulli VII: Amnistia dhe Falja, f. 572, 573.

<sup>66</sup> Neni 113, Efekti i faljes në personat e tretë, Kodi Penal i Republikës së Kosovës.



## VI. REKOMANDIMET

Në vazhdim do të paraqesim disa rekomandime të cilat synojnë të kontribuojnë në një ligj sa më të mirë:

1. Falja duhet të mos kufizoj në mënyrë kategorike veprat e caktuara penale
2. Duhet të hiqet kufizimi për faljen e të dënuarve që refuzohen nga Paneli për Lirim me Kusht
3. Kriteret duhet të saktësohen me ligj. Kriteret aktuale të dekretit duhet të futen në ligj.
4. Kriteret duhet të theksojnë se Dekreti i Presidentit duhet të vendos masa rënduese për veprat penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore të përcaktuara si të tilla me dokumente të ndryshme shtetërore.
5. Duhet themeluar mekanizma të përhershëm të cilët merren me grumbullimin e lutjeve dhe të dosjeve të personave të dënuar që kërkojnë falje
6. Duhet vendosur kufizime kohore sa i përket çështjes së kërkesës për falje, varësisht nga dënimi (p.sh. të dënuarit me më pak se tre vjet burgim kanë të drejtë të paraqesin kërkesën e radhës pas 6 muajve të vendimit të fundit, ata të cilët kanë dënim të përjetshëm paraqesin kërkesën e radhës tek pas 10 vitesh prej vendimit të fundit)
7. Presidentëve duhet ndaluar e drejta për falje katër muaj para dhe pas shpalljes së zgjedhjeve.

## Aneks 1 – Rastet e falura në vitin 2010 dhe 2011

Vepra	Presidenti Fatmir Sejdiu					Ushtruesi i detyrës së Presidentit Jakup Krasniqi				
	Veprat		Faljet 2010		Mesatarja	Veprat		Faljet 2011		Mesatarja
	Numri	% nga totali	Numri	% nga totali		Numri	% nga totali	Numri	% nga totali	
Vrasje	14	23%	162	38%	11.57	52	50%	1260	67%	25.71
Vrasje e rëndë	2	3%	36	8%	18.00	11	11%	360	19%	32.73
Krim i organizuar	3	5%	15	4%	7.50	0	0%	0	0%	0.00
Narkotik*	5	8%	21	5%	4.20	0	0%	0	0%	0.00
Trafikim me njerëz	1	2%	6	1%	6.00	0	0%	0	0%	0.00
Dhunim	1	2%	0	0%	0.00	0	0%	0	0%	0.00
Mbajtja e armës**	0	0%	0	0%	0.00	4	4%	18	1%	6.00
Furnizim i armëve***	0	0%	0	0%	0.00	2	2%	12	1%	6.00
Përvetësimi në detyrë****	0	0%	0	0%	0.00	2	2%	3	0%	3.00
Shpërdorimi	1	2%	0	0%	0.00	1	1%	3	0%	3.00

Tabela 1 - Krahasim i veprave penale nga më të rëndat të falura nga Presidenti Fatmir Sejdiu në vitin 2010 dhe Presidenti në Detyrë Jakup Krasniqi në vitin 2011

\* Vepra që ndërlidhen me narkotik dhe substanca psikoterapike

\*\* Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve

\*\*\* Furnizim, transport, prodhim, këmbim ose shitje e paautorizuar e armëve

\*\*\*\* Përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës

## Aneks 2 – Ngjashmëritë dhe dallimet e kriterëve për falje (Ligjit për Faljen dhe Dekreti i Presidentit) dhe Lirimit me Kusht

Kriteret në Ligjin për Falje	Kriteret në Dekretin e Presidentit	Kriteret e Panelit për Lirimin me Kusht	
Pesha e Krimit	Pesha e Krimit	Pesha e krimit	
Rreziku i recidivizmit	Rrezikun e recidivizmit dhe recidivizmin	Historia e kaluar kriminale Ekzistenca e një rrezi kutë për gjithë lirin për publikun	
Pendimi i sinqertë	Pendimi i sinqertë	Që ndi mi personit të dënuar në viktims Pë rshkri mi personit të dënuar për kr	
Shfaqja e sjelljeve dhe karakterit të respektueshëm	Shfaqja e sjelljeve dhe karakterit të respektueshëm	Sjellja gjatë burgut	
	Pë r mbushjen e kë rkesave të shë rbi rit korrekt ues		
	Respektimin e rregullave për socializim dhe riintegrim		
	*		Gjendja psikiatrike apo psikologjike
	*		Historia sociale dhe kontaktet familjare
Shfaqja e sjelljeve dhe karakterit të respektueshëm	*	Planet e personit të dënuar për lirin	
	*	Pranimi i kontrollit dhe ndihmesë s nga Shë rbi ri Sprovuesi Kosovë	
		Perspektiva që një personi dënuar origjinë të huaj la synimin që të kthe në shtëpi	
		Gjendja fizike	
	Kohë e kaluar në vuajtjen e dënimit		
	Arsyen specifike humanitare për falje		
	Ndikimin e faljes të palës së dënuar		

### Aneks 3 – Pasqyrë rreth të dënuarve që vuajnë dënimet në Shërbimin Korrektues të Kosovës

Kategoria sipas moshë	<18 vjet	18-25	26-45	46-60	>60
Institucionet korrektuese/burgjet	6	240	731	161	52

Burimi: Shërbimi Korrektues i Kosovës

Kategoria sipas veprave penale	Plaçkitje	Vjedhje	Vrasje	Plagosje	Dhunim	K/vajtje	Droge	Tjera
Institucionet korrektuese / burgjet	103	226	317	30	30	7	140	337

Burimi: Shërbimi Korrektues i Kosovës

Kategoria sipas kohë zgjatjes së dënimit	< 6 muaj	6m.-1vjet	1-2 vjet	2-5 vjet	5-15 vjet	15-40 vjet
Institucionet korrektuese/burgjet	155	82	175	297	342	147

Burimi: Shërbimi Korrektues i Kosovës